

Nr. 1241 Prot
14.10.2020



Fatiom
Sh. publikohet
14.10.2020
Prof. Dr.
Gentil
Rogner
Admiral
14.10.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLL ARKIVËS

Nr. 2307/prot.
1

Tiranë, më 13.10.2020

Lënda: Përcillet Urdhri i Rektorit me nr. 90 datë 07.10.2020.

FAKULTETIT TË MJEKËSISË

Këtu

FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE, TEKNIKE ✓

Këtu

FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE

Këtu

Me anë të kësaj shkrese, ju përcjellim Urdhrin e Rektorit me nr. 90 datë 07.10.2020

Duke ju falenderuar,

REKTORI
Arben GJATA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2307 prot

Tiranë, më 07.10.2020

URDHËR
Nr. 98 datë 07.10.2020

**“PËR
PUNËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME,
PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021,
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe në Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe në procedurën e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2020-2021,

URDHËROJ:

Propozimet e secilit njësi kryesore / fakultet për personelin akademik me kohë të pjesshme të përgatiten si më poshtë:

I. Përgatitja e propozimeve për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020-2021

Propozimi i secilës njësi bazë / departament, për personel akademik me kohë të pjesshme do të përgatitet bazuar në nevojat që ka dhe do të dërgohet pranë Dekanatit të secilit fakultet të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, duke iu përmbajtur fazave të mëposhtme:

1. Përcaktimi i nevojave dhe kriterëve të punësimit për personel akademik me kohë të pjesshme nga Njësia Bazë

Njësia Bazë / Departamenti, si fillim, në propozimin e tij duhet të pasqyrojë një përmbledhje të ngarkesës dhe mbingarkesës mësimore të secilit pedagog të brendshëm sipas planit mësimor. Pasi të jetë realizuar shpërndarja e ngarkesës dhe mbingarkesës mësimore, sipas legjislacionit në fuqi, për secilin pedagog të brendshëm, do të përgatiten kërkesat për personel akademik me kohë të pjesshme në përputhje me ngarkesën mësimore të pambluar dhe duke pasur parasysh përcaktimet e akteve nënligjore për të.

Njësia bazë / Departamenti duhet të parashikojë dhe të pasqyrojë saktë numrin e nevojshëm të pedagogëve të jashtëm, si dhe ngarkesat mësimore që do të ketë secili prej tyre. Gjithashtu, në numrin e kërkuar të personelit akademik me kohë të pjesshme duhet të parashikojë që të mbulohen nevojat për të gjithë vitin akademik, duke marrë në konsideratë programet mësimore, si dhe mungesat e krijuara nga pedagogët gjatë vitit akademik 2019-2020 (leje, largime, numrin e orëve shtesë që mund të realizohen etj.).

Njësia bazë / Departamenti duhet të përgatisë dhe të përfshijë në këtë propozim edhe kriteret e punësimit për personelin akademik me kohë të pjesshme, në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi për punësimin.

2. Përcaktimi i nevojave për mbikëqyrës klinik

Mbikëqyrësit klinik duhen të jenë personel mjekësor i qendrave spitalore universitare dhe të kenë përfunduar studimet universitare me notë mesatare mbi 7 (shtatë). Përfshihen nga kriteri i mesatares vetëm kryeinfermieret e pavijoneve spitalore.

3. Përcjellja e kriterëve në Dekanat për miratim dhe publikim

Njësia bazë / Departamenti dërgon propozimin e tij në Dekanat, i cili miratohet pasi të ketë verifikuar numrin e pedagogëve të kërkuar, ngarkesat mësimore dhe kriteret e punësimit bazuar në nevojat aktuale të fakultetit dhe të jetë siguruar që janë zbatuar legjislacionet në fuqi. Në këtë fazë vijohet me fillimin e procedurave të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme.

4. Kohëzgjatja e publikimit të kriterëve dhe vlerësimi i dosjeve

Kriteret e punësimit për personelin akademik me kohë të pjesshme do të shpallen në faqen zyrtare të secilit fakultet dhe të universitetit, ku do të qëndrojnë të hapura 7 (shtatë) ditë pune, kohë gjatë së cilës kandidatët mund të dorëzojnë dokumentet përkatëse me qëllim aplikimin e tyre për pranim.

Njësia Bazë / Departamenti në bashkëpunim me specialistin e burimeve njerëzore në fakultet, do të grumbullojë aplikimet me dosjet përkatëse, si dhe do të kryejë procedurën e vlerësimit të dokumentacionit dhe seleksionimit të kandidatëve (nëpërmjet dosjeve dhe intervistave).

5. Përgatitja e listës përmbledhëse nga Njësia Bazë / Departamenti dhe dërgimi për miratim në Dekanat

Në përfundim të seleksionimit të kandidatëve do të përgatitet, në bashkëpunim me specialistin e burimeve njerëzore në fakultet, propozimi i secilës njësie bazë / departament sipas formatit të tabelës bashkëlidhur duke plotësuar të gjitha të dhënat e kërkuara për personelin akademik me kohë të pjesshme. Gjatë përgatitjes së listës së personelit akademik me kohë të pjesshme duhet t'i

jepet rëndësi e veçantë, që në dosjen e secilit kandidat fitues të mos mungojë leja e punëdhënësit për kandidatët të cilët janë të punësuar jashtë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Nëse kandidati fitues është në marrëdhënie pune në institucione të tjera, leja e punëdhënësit duhet të dorëzohet nga vetë individi.

Në rastin kur është pedagog në një universitet tjetër do të kërkohet leje për zhvillimin e orëve mësimore nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në universitetin përkatës, sipas një liste përmbledhëse për të gjithë kandidatët fitues.

Propozimi final me listën e personelit akademik me kohë të pjesshme do të dërgohet në Dekanat për verifikim dhe miratim. Dekanati do të vijojë me përcjelljen e listës në Rektorat për miratim nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Afatet dhe fazat e parashikuara për realizimin e kësaj procedure paraqiten sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 1: Fazat dhe afatet për realizimin e procedurës së rekrutimit të personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020-2021

Faza	Procedura e parashikuar	Afati i parashikuar (në ditë pune)
Fillimi i procedurës: data 07.10.2020		
1	Përcaktimi i nevojave (numri dhe ngarkesat mësimore dhe kriterëve të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme nga Departamenti	5
2	Përcjellja e kriterëve në Dekanat për miratim dhe publikim në website-n e fakultetit, si dhe dërgimi i kriterëve në Rektorat për t'u publikuar në website-n e Universitetit.	2
3	Kohëzgjatja e publikimit të kriterëve ne website	7
4	Dorëzimi i dosjeve të kandidatëve	4
5	Vlerësimi i aplikimeve nga Departamenti	4
6	Përgatitja e listës nga Departamenti dhe dërgimi për miratim në Dekanat	3
7	Verifikimi i propozimeve, miratimi i listës përmbledhëse nga Dekanati, si dhe përcjellja e saj në Rektorat për miratim nga Senati Akademik sipas formatit të tabelës bashkëlidhur.	2
Afati maksimal i përfundimit të procedurës: data 30.10.2020		23 ditë

II. Kriteret që duhet të plotësojë personeli akademik me kohë të pjesshme

Personeli akademik me kohë të pjesshme duhet të përmbushë kriteret dhe kërkesat për punësim në të njëjtën mënyrë si personeli akademik me kohë të plotë. Njësia bazë / Departamenti në bashkëpunim me Shërbimin do të përshtat kriteret sipas nevojave të tij në publikimin e vendeve të punës për personel akademik me kohë të pjesshme.

1. Kriteret e përgjithshme për personel akademik me kohë të pjesshme

Personel akademik në Njësinë bazë / Departamentin apo Shërbimin përkatës.

1. Të jetë diplomuar në programe të integruara ose Master Shkencor në degën përkatëse;
2. Të ketë përfunduar studimet universitare me notë mesatare mbi 8. Në rastin kur nuk paraqiten brenda afatit 7 (shtatë) ditor kandidatë me notë mesatare mbi 8 (tetë), mund të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ulët, pas miratimit paraprak nga Departamenti përkatës;
3. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vite në specialitetin përkatës (*për lëndët klinike*);
4. Të zotërojë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore, preferohet gjuha angleze;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

***Secila Njësi bazë / Departament në bashkëpunim me Shërbimin shton kriteret sipas specifikave dhe nevojave të tij**

Kriteret preferenciale:

1. Të ketë Doktoraturë në fushën përkatëse;
2. Të ketë eksperiencë pune;
3. Të ketë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesmarrje në kërkim shkencor;
4. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
5. Të ketë të mbrojtur me dëshmi gjuhën angleze;
6. Të jetë i diplomuar në fushën përkatëse në Master Shkencor dhe/ose Doktoraturë;

III. Dokumentacioni që do të dorëzohet nga të interesuarit për të aplikuar për personeli akademik me kohë të pjesshme në UMT

1. Kërkesë me shkrim drejtuar njësisë bazë / departamentit ku do të konkurrojnë;
2. Curriculum Vitae e detajuar me të gjithë aktivitetin shkencor dhe botues të kandidatit;
3. Leje nga punëdhënësi në organizatën ose institucionin ku punon;
4. Dokument identifikimi;
5. Fotokopje të noteruara të diplomës dhe listë së notave të të gjitha programeve të studimit (Bachelor, Master Shkencor, Doktoraturë);
6. Fotokopje të noteruara të vërtetimit të ekuivalentimit të diplomës nga MAS, si diplomë, listë notash si dhe njohje të gradave për kandidatët që kanë studiuar jashtë shtetit;

7. Kopje të noteruara të dëshmimeve të gjuhëve të huaja të mbrojtura (e detyrueshme të paktën një);
8. Kopje të noteruar të librezës së punës;
9. Vërtetim page, shoqëruar me derdhjen e sigurimeve shoqërore nga qendra e punës;
10. Dëshmi penaliteti;
11. Dy referenca nga të cilat të paktën njëra të jetë nga një profesor i fakultetit që është diplomuar (dorëzohet vetëm nëse kandidati aplikon për herë të parë).

IV. Bazuar në situatën në të cilën gjendemi dhe me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit Covid -19, Njësia Bazë / Departamenti nëpërmjet vlerësimit të performancës, kritereve aktuale që duhet të plotësojnë personat që do të jenë personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020-2021 dhe dokumentacionit, të propozojnë vijimin e punës së personelit akademik me kohë të pjesshme që janë shpallur fitues, janë miratuar nga Senati Akademik i UMT-së dhe kanë realizuar detyrimet e tyre në vitin akademik 2019-2020.

Nëse njësia bazë / departamenti do të ketë nevojë për një numër më të madh personeli akademik me kohë të pjesshme, apo për vendet vakante, bazuar dhe në ngarkesën mësimore që ka, atëherë për plotësimin e këtyre vendeve apo nevojave do të kryej të gjithë procedurën e punësimit sipas përcaktimeve të këtij urdhri, përfshirë dhe intervistën.

V. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkivë Protokollit në UMT, Njësiti Kryesorë / Fakultetet dhe Njësiti Bazë / Departamentet, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

VI. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Arben GJATA

